

**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**  
**SHTYLLA II - LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT**

**Komponenti V:**  
**Ndërtimi i një shoqërie me integritet**

Objekti dhe qëllimi

Analiza e këtij komponenti ka si qëllim të vlerësojë situatën aktuale, gjetjet kryesore, arritjet dhe problematikat e evidentuara si dhe nevojat për ndërhyrje për ndërtimin e një shoqërie me integritet, si një përgjegjësi jo vetëm e institucioneve publike por e gjithë shoqërisë. Analiza është ndalur në dy aspekte të rëndësishme; në mekanizmat ligjore dhe institucionale ekzistues për identifikimin, raportimin, ndjekjen dhe hetimin e rasteve të korrupsionit nga qytetarët, sinjalizuesit, aktorët e shoqërisë civile, grupet e interesit, etj., duke pasur një fokus të veçantë edhe tek mekanizmat mbrojtëse dhe garancitë për denoncuesit, si dhe në analizën e situatës për vlerësimin e mundësive ligjore dhe institucionale për mbështetjen e aktorëve të shoqërisë civile, ndërgjegjësimin e qytetarëve si dhe të brezave të rinj në programet arsimore për ndërtimin e shoqërisë me integritet dhe parandalimin e korrupsionit. Në përgatitjen e kësaj analize janë shqyrtuar raportet e progresit të Bashkimit Evropian (BE), raportet e vlerësimit të grupit të I “Themeloret” dhe i Shtetit të së Drejtës, udhërrëfyesit e miratuar nga Qeveria shqiptare, raportet e organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile në këtë fushë, dokumentat strategjike dhe të politikave të Qeverisë shqiptare, të dhënat sasiore, kuadri ligjor në fuqi, etj.

## Hyrje

Kuadri ligjor dhe institucional për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit ka pësuar zhvillime të rëndësishme përmes marrjes së masave gjithëpërfshirëse si dhe ratifikimit të një sërë akteve ndërkombëtare dhe miratimit të strategjive për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e fenomenit të korrupsionit, siç reflektohet edhe nga Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë. Megjithatë, vihen re disa mangësi të rëndësishme, jo vetëm në kuadrin ligjor por edhe atë institucional që mbeten për t’u përmirësuar.

Për të vijuar përpjekjet e shtetit kundër korrupsionit, është e nevojshme që të gjithë aktorët e shoqërisë – si shoqëria civile, sektori privat, academia, media dhe publiku në tërësi – të luajnë një rol ndërveprues, aktiv dhe konstruktiv. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i shoqërisë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit në kuadër të ndërtimit të një shoqërie me integritet është objektivi i disa dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, me një vend të veçantë në Strategjinë e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) për periudhën 2024-2030, e cila është aktualisht në fazën e konsultimit publik.

Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në këtë objektivi, jo vetëm në ndërgjegjësimin e shoqërisë, por edhe sinjalizimin dhe denoncimin e rasteve të korrupsionit. Në këtë kontekst, është thelbësore të rritet ndërgjegjësimi publik dhe edukimi i qytetarëve për fenomenin e korrupsionit në tërësi, format e manifestimit të tij dhe pasojat që shkakton në shoqëri. Ndërkohë, krijimi i mekanizmave të besueshëm për sinjalizimin e rasteve korruptive është imangët ashtu si dhe masat mbrojtëse të sinjalizuesve dhe denoncuesve të korrupsionit, si mjete

efektive për të inkurajuar raportimin dhe për të ndihmuar në çrrënjosjen e korrupsionit në të gjitha nivelet e shoqërisë.

## **I. Gjetjet kryesore dhe çështjet për adresim për nxitjen e denoncimeve të rasteve të korrupsionit nga aktorëve e shoqërisë civile, qytetarët, grupet e interesit, etj si dhe mbrojtja e tyre**

Në kuadrin ligjor dhe institucional janë ndërmarrë një sërë masash për të përforcuar arkitekturën ligjore dhe krijimin e strukturave përgjegjëse për trajtimin e rasteve të denoncuarra të korrupsionit. Pavarësisht përpjekjeve të bëra nga qeveria dhe institucionet në kuadër të luftës kundër korrupsionit, sipas Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP) niveli i besimit të qytetarëve shqiptarë në institucionet e sigurisë, drejtësisë ende mbetet i ulët.

Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, luan një rol të rëndësishëm **për sinjalizimin e korrupsionit në sektorin publik dhe atë privat**, ku rol të rëndësishëm luajnë Njësitë Përgjegjëse (191 njësi në sektorin publik dhe 593 njësi në sektorin privat) dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI). Miratimi i ligjit është vlerësuar pozitivisht, i cili është pjesërisht i harmonizuar me *acquis* e BE-së. Megjithatë, ajo që vihet re në zbatim është **evidentimi i një numri të ulët sinjalizimesh korrupsioni** në vendin e punës veçanërisht në sektorin privat. Nga analiza e të dhënave dhe raporteve të ILKDPI-së 2018 – 2023 por edhe të raporteve ndërkombëtare rezulton se numri i sinjalizimeve të brendshme është gati i papërfillshëm. Konkretisht në harkun kohor 2018-2022 në NjP në kuadër të sinjalizimit të brendshëm janë raportuar: *në vitin 2018 - 5 raste; në vitin 2019 - 12 raste; në vitin 2020 - 7 raste; në vitin 2021-9 raste, në vitin 2022 - 22 raste dhe në vitin 2023 – 6 raste*). Po ashtu, numër i vogël sinjalizimesh janë edhe ato për sinjalizimin e jashtëm për periudhën 2019 – 2023 (rreth 85). Sinjalizimet janë bërë kryesisht ndaj institucioneve publike, duke përfshirë ministrinë, institucionet e pavarura, bashkitë dhe universitetet. Objektet e sinjalizimit kanë përfshirë shkelje të procedurave të administrimit të fondeve publike, shkelje në rekrutime dhe raste të dyshuara të konfliktit të interesave. Ndër arsyt kryesore për numrin e ulët të raportimeve të sinjalizuesve përmendet vetë-censura dhe mungesa e besimit në efektivitetin e masave mbrojtëse, e theksuar dhe në Raportin e Shtetit të së Drejtës (2024).

Në nivel lokal, bazuar në analizën e kryer, nga raporti i monitorimit të Komitetit Shqiptar i Helsinkit (2024) për zbatimin e ligjit në praktikë në 9 bashki të vendit rezulton se përveç mungesës së sinjalizimeve të brendshme pranë NjP në këto bashki për vitin 2022-2023, ekzistojnë problematika lidhur me identifikimin e NjP; mungesën e vendosjes së emërimit dallues si NjP, duke e specifikuar vetëm si Drejtoria e Auditit (psh: NjP pranë Bashkive Korçë, Fier apo Durrës); mungesën e vendosjes së tabelave dhe simboleve identifikuese në ambientet e jashtme (psh: NjP pranë Bashkisë Vlorë apo Kukës), ose mungesën e një zyre të dedikuar për funksionimin si NjP (psh: NjP pranë Bashkisë Elbasan apo Durrës); në lidhje me kanalën e komunikimit dhe përcjelljes së sinjalizimit.

Një problematikë e evidentuar edhe në parashikimet ligjore është mungesa e mbrojtjes së personave që raportojnë shkelje të ligjit të Bashkimit Evropian. Ashtu siç evidentohet në zbatimin e këtij ligji, se nuk janë vënë në dispozicion raste praktike që provojnë **efektivitetin e mbrojtjes së sinjalizuesve**, çështje penale të nisura, ose pasoja të tjera që rezultojnë nga sinjalizimi, evidentuar kjo edhe në raportin e OECD, “Perspektiva e Konkurrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor (2024)”. ILDKPKI ka marrë një sërë masash administrative me gjobë në rastet e refuzimit të mbrojtjes së sinjalizuesve.

Në raportin e OECD për Shqipërinë 2024, evidentohet se Shqipëria ka krijuar disa institucione kundër korrupsionit me burime financiare dhe njerëzore në rritje. Deri në vitin 2024 një rol mjaft të rëndësishëm në këtë drejtim e ka luajtur Ministria e Drejtësisë dhe tani Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, po ashtu Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, të cilët kanë kompetenca të plota për parandalimin e korrupsionit dhe raportet e performancës zbulojnë aktivitete të gjera në fushat e tyre të kompetencës. Por problematikë e cila është evidentuar gjatë analizës së kryer, rezultojnë **mbivendosja e funksionimit të disa institucioneve dhe strukturave me kompetenca për pritjen/marrjen e denoncimeve të korrupsionit dhe ndjekjen dhe hetimin e rasteve të tyre**. Agjencia për dialog dhe bashkëqeverisje administron platformën “*Me ty për Shqipërinë që duam*” në të cilën qytetarët mund të denoncojnë edhe rastet e korrupsionit në ofrimin e shërbimeve publike. Një prej seksioneve të platformës, është “*Denonco korrupsionin*”, ku mund të denoncohen aktet korruptive apo kur konstatohet se në përmbajtje të çështjes ka elemente të një akti korruptiv të ndodhur ose në tentativë. Nga ana tjetër, Drejtoria e përgjithshme antikorrupsion (DPKA) së bashku me rrjetin e koordinatorëve antikorrupsion marrin, ndjekin dhe hetojnë administrativisht rastet e korrupsionit. Agjencia për dialog dhe bashkëqeverisje në rastet e denoncimeve të korrupsionit apo të indicieve për elementë korruptive, ia përcjell çështjen për trajtim Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, por pavarësisht kësaj ka një mbivendosje dhe paqartësi se si Agjencia ndjek ankesat për korrupsion dhe mënyrën se si kjo e fundit ndërvepron me Rrjetin e Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, si dhe ndarjen e roleve ndërmjet dy organeve. Edhe në Progres raportin për Shqipërinë të KE-së (2024) theksohet se mbeten sfida për t’u adresuar rishikimit të kapaciteteve dhe roleve të koordinatorëve anti-korrupsion dhe sigurimin e koordinimit efektiv ndërmjet institucioneve duke përfshirë atë në nivel lokal.

Bazuar në analizën e të dhënave të administratuara nga DPAK, gjatë periudhës 2021 – 2023 rezultojnë 1991 ankesa / denoncime, të cilat janë bërë pjesë e verifikimeve dhe hetimeve administrative, për të cilat 121 kanë rezultuar me raporte përfundimtare. Janë propozuar mbi 100 masa disiplinore për largim nga detyra, dhe 48 kallzime penale. Nga analiza e të dhënave nuk krijohet mundësia e ecurisë së zbatimit të masave të propozuara dhe kallzimeve të referuara.

Nga analiza e kryer, pavarësisht nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis institucioneve, vihet re një mbivendosje e përgjegjësi që luajnë koordinatorët anti-korrupsion në institucionet qendrore me rolin e sinjalizuesve duke sjellë kështu paqartësi dhe mungesë efektiviteti. Në kuadër institucional, marrin rëndësi edhe veprimtaria e institucioneve/struktura të tjera me kompetenca për hetimin e rasteve të korrupsionit në autoritetet publike, të tilla si: Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion), pjesë e strukturës së Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve, Doganave, etj, Njësitë përgjegjëse për Inspektim Financiar Publik, pjesë e strukturës së Ministrisë së Financave, etj si dhe struktura të tjera publike, gjë që sjell një mbivendosje me përgjegjësitë e DPKA-së. Ngritja e institucioneve të ndryshme të cilat lidhen me pritjen, ndjekjen dhe hetimin e rasteve të korrupsionit sjell konfuzion dhe mbivendosje jo vetëm në drejtim të qytetarit por edhe në efektivitetin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve të tyre.

Pavarësisht parashikimeve ligjore për mënyrën e trajtimit të rasteve të korrupsionit nga analiza rezultojnë se nuk janë të qarta në zbatim dhe procedurë garancitë mbrojtëse të qytetarëve që denoncojnë korrupsionin në të gjithë arkitekturën e tyre, e veçanërisht kjo si një aspekt i pambuluar për denoncimet në pushtetin vendor.

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të ligjit, identifikimin e problematikave dhe dhënien e raportimeve për përmirësimin e tij. Lidhur me **përfshirjen e shoqërisë civile dhe të qytetarëve** në mbikëqyrjen e financave publike si një mekanizëm për të parandaluar korrupsionin, paraqiten një sërë sfidash. Ka shqetësime lidhur me efektivitetin e procesit të konsultimit, pasi rekomandimet e shoqërisë civile shpesh nuk reflektohen në politikat publike. Kufizimet financiare dhe teknike e bëjnë të vështirë monitorimin efektiv të financave publike nga OSHC-të, të cilat mbështeten kryesisht te donatorët e jashtëm për financim të kufizuar.

Sipas Raportit të SIGMA-s (2021), ndërsa ekzistojnë ligje që garantojnë aksesin në informacionin publik, në praktikë organizatat e shoqërisë civile shpesh përballen me vështirësi në marrjen e të dhënave në kohë dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me financat publike. Pavarësisht mekanizmave formalë që lejojnë angazhimin e shoqërisë civile, nuk ka garanci të mjaftueshme për të siguruar që proceset e prokurimit të jenë transparente dhe që kontratat të jepen në mënyrë të drejtë. Po ashtu, kuptimi i publikut për rëndësinë e rolit të shoqërisë civile në monitorimin e financave publike mbetet i ulët.

***Më poshtë paraqesim disa çështje që kanë nevojë për t'u adresuar:***

- **Në kuadër të mbivendosjeve në përgjegjësi dhe kompetenca të arkitekturës institucionale** për antikorrupsionin, të DPAK-së dhe koordinatorëve të rrjetit antikorrupsion, strukturat antikorrupsion në drejtoritë e përgjithshme të tatimeve, doganave, etj, me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, ILDKPKI apo institucioneve të tjera që janë ngarkuar për pritjen/marrjen e denoncimeve si dhe ndjekjen dhe hetimin e rasteve të korrupsionit.
- **Bërja efektive e mekanizmit të sinjalizimit** nëpërmjet përmirësimit dhe përafrimit të ligjit me *acquis* të BE-së, forcimit të kapaciteteve profesionale të anëtarëve të njëjësive përgjegjëse dhe rritjes së ndërveprimit të njëjësive përgjegjëse, si dhe garantimin e mbrojtjes efektive për sinjalizuesit që raportojnë raste korrupsioni.
- **Ofrimi i garancive të mbrojtjes duke ruajtur anonimatit e denoncuesve** dhe të sinjalizuesve të rasteve të korrupsionit, në funksion të nxitjes së raportimeve të brendshme dhe të jashtme, duke garantuar nëpërmjet sistemeve online dhe platformave raportuese.
- Në drejtim të **forcimit të kuadrit institucional për angazhimin e OSHC-ve**, për të garantuar më shumë akses në informacionin financiar publik dhe nxitjen e një mjedisi më bashkëpunues për kontributin e shoqërisë civile, ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve dhe sigurimin e burimeve të qëndrueshme të financimit janë thelbësore për fuqizimin e tyre për të monitoruar menaxhimin e financave publike në afat të gjatë.
- Zhvillimi i mëtejshëm i **platformave të qeverisjes elektronike** dhe mjeteve digjitale mund të rrisë transparencën proaktive në tërësi dhe atë në drejtim të menaxhimit të financave publike në veçanti.
- **Në transformimin e ciklit të GMIP-së** (Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave) në një mekanizëm ku mund të ofrohen vlerësime ekspertësh të proceseve të zbatimit të politikave, shoqëria civile të përfshihet në mënyrë praktike në dialog nëpërmjet përfaqësimit të nivelit të lartë, ashtu si dhe pjesëmarrëse në aktivitetin e SASPAC-ut.

## **II. Gjetjet kryesore dhe çështjet për adresim për zbatimin e politikave për ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe veçanërisht të rinjve për ndërtimin e një shoqërie me integritet**

Në kuadrin ligjor rregullues të shoqërisë civile Progres Raporti i KE (2024), vlerëson se korniza ligjore për të drejtën e lirisë së tubimit dhe organizimit është në përputhje me standardet

ndërkombëtare. Megjithatë, **regjistri elektronik kombëtar i organizatave jofitimprurëse** ende nuk është bërë plotësisht funksional edhe pse ishte planifikuar të ishte në fuqi deri në fund të vitit 2023. Këto vonesa mund të krijojnë vështirësi jo vetëm në identifikimin OSHC-ve aktive në vend, por edhe në ndërveprimin me aktorët e duhur të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme dhe me ekspertizë në luftën kundër korrupsionit.

Shqipëria ka nënshkruar zotimin për transparencë sipas UNCAC, duke **bashkëpunuar ngushtë me organizatat e shoqërisë civile (OSHC)** në luftën kundër korrupsionit. Kuadri rregullues për procesin e konsultimit publik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) ofron transparencë për procesin e miratimit të projektligjeve apo akteve strategjike kombëtare pavarësisht se ka një interes jo të lartë nga aktorët e shoqërisë civile. Në përpjekjet për të promovuar sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit, qeveria ka krijuar një rrjet bashkëpunimi me 13 OSHC. Ndërsa rrjeti i OSHC-ve me të cilat Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe DPAK bashkëpunon në drejtim të luftës kundër korrupsionit përfshihen 27 OJF dhe 4 anëtarë nga academia.

Gjithashtu, **Shqipëria duke qenë edhe pjesë e Partneritetit OGP** (Partneriteti i Qeverisjes së Hapur) ka përmirësuar vazhdimisht procesin e hartimit të Planit të Veprimit Kombëtar për OGP duke bashkë-hartuar këtë dokument në bashkëpunim të ngushtë me OSHC aktive në vend. Prej vitit 2020, është ngritur edhe Kualicioni me OSHC, në edicionin e Javës së Integritetit 2020, zhvilluar në Tiranë, dhe rregullisht ndan dhe konsulton akte të saj, strategjitë antikorrupsion, planet e veprimit (gjatë kohës së hartimit të tyre) si dhe raportet e monitorimit për zbatimin e planit të veprimit antikorrupsion mbi baza 6-mujore.

Nevoja për rishikim të **ligjit për vullnetarizmin** synon adresimin e sfidave të identifikuara në raportin e KE Screening për Grupkapitullin I, ku vullnetarizmi përbën një nga prioritetet për të krijuar një mjedis mundësues për shoqërinë civile, sipas kriterit politik. Në raportin e Progresit të KE-së për 2024, theksohet se nuk ka pasur përparim në zbatimin e Udhërrëfyesit të Qeverisë për Mundësimin e Mjedisit për Shoqërinë Civile 2019-2023, as në forcimin e strukturave dhe mekanizmave për dialog dhe koordinim midis qeverisë dhe shoqërisë civile, ndërsa kuadri i ri strategjik ende nuk është vendosur. Përmirësimi i procesit të monitorimit të Udhërrëfyesit është i domosdoshëm në mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave për të forcuar politikëbërjen e bazuar në dëshmi dhe për të rritur besimin e shoqërisë civile. Po ashtu, Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike (2024) përfshin një sërë masash të dedikuara për aksesin dhe përfshirjen e shoqërisë civile, të cilat kërkojnë zbatim në vijim.

**Kontributi i shoqërisë civile në proceset integruese të BE-së** është i pranishëm, por kërkon përforcim, pasi në vitin 2024, aktorët joqeveritarë përbëjnë vetëm 11% të pjesëmarrësve në konsultimet publike. Raport Progresi i KE-së (2024), përmend se është bërë njëfarë progresi në krijimin e Platformës së Partneritetit të Integritetit Evropian për tavolina konsultimi dhe diskutimi. Megjithatë buxheti për mbështetje është rritur, financimi publik nuk siguron qëndrueshmërinë e OSHC-ve, të cilat varen nga donatorët e huaj. Pavarësisht se ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut janë prioritetet strategjike, informacioni mbi financimin kombëtar për këto aktivitete është i kufizuar.

Një rol të rëndësishëm në **rritjen e ndërgjegjësimit qytetar** për rëndësinë e zbatimit të ligjit e ka luajtur Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Plani i Veprimit 2020-2023. Edukimi ligjor për fenomenin e korrupsionit në Shqipëri është realizuar kryesisht nga

organizata jofitimprurëse me mbështetje ndërkombëtare, duke theksuar nevojën për rritjen e koordinimit dhe institucionalizimit nga institucionet publike. Për herë të parë në vitin 2020, për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e korrupsionit, nisi një projekt pilot me **programe kurrikulare në institucionet parauniversitare**. Deri tani janë nënshkruar dy Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe Ambasadës Italiane në Tiranë. Pavarësisht këtyre përpjekjeve të cilat do të shërbejnë për t'i hapur udhë rishikimit të kurrikulës arsimore para universitare dhe për të përfshirë tema për antikorrupsionin për çdo nxënës, përsëri mbetet e nevojshme që të ketë përpjekje të strukturuar dhe të qëndrueshme. Po ashtu, **krijimi i një qendre kërkimore** dhe zhvilluese me fokus në fushën e integritetit dhe mirëqeverisjes si bashkëpunim i katërfishtë “Quadruple helix” mes institucioneve akademike, sektorit privat, sektorit publik dhe shoqërisë civile për të krijuar një hapësirë shoqërore dhe të ekonomisë të bazuar në njohuri dhe të dhëna.

*Në kuadër të vlerësimeve dhe konstatimeve si dhe të analizës së kryer për këtë aspekt, duke përfshirë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të Komisionit Evropian, të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë si dhe atyre lokalë, si më poshtë paraqesim disa çështje që kanë nevojë për t'u adresuar:*

- **Rishikimi i kornizës ligjore** për të përfshirë më aktivisht aktorët e shoqërisë civile, në drejtim të Këshillit Kombëtar kundër Korrupsionit, miratimin e Udhërrëfyesit të ri për mjedisin mundësues për OSHC-të, 2024-2027 si dhe rishikimin e ligjit “Për vullnetarizmin”, çka do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e një mjedisi mundësues për nxitjen e vullnetarizmit në vend.
- **Forcimi i mbështetjes ndaj aktorëve të shoqërisë civile nëpërmjet granteve të AMSHC dhe të donatorëve** për iniciativa për ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe denoncimin e korrupsionit
- **Rritja e ndërgjegjësimit dhe nxitja e pjesëmarrësve nga shoqëria civile dhe grupet e tjera të interesit në procesin e konsultimit publik përmes:** identifikimit të OSHC-ve sipas ekspertizës së tyre, bashkëpunimi me institucionet e Arsimit të Lartë, bashkëpunimi me sektorin privat, krijimit të një platformë kombëtare me fokus luftën kundër korrupsionit ku drejtimi i platformës të jetë i përbashkët me një aktor tjetër të shoqërisë civile në mënyrë të përkohshme me rotacion.
- **Integrimi i edukimit** kundër korrupsionit në kurrikulat shkollore si një hap i rëndësishëm për promovimin e sjelljes etike që në moshë të re dhe për ndërtimin e një themeli të fortë për përpjekjet afatgjata kundër korrupsionit, si një masë e qëndrueshme
- **Krijimi i qendrave kërkimore dhe zhvilluese** me fokus në fushën e integritetit dhe mirëqeverisjes si bashkëpunim i katërfishtë “Quadruple helix” mes institucioneve akademike, sektorit privat, sektorit publik dhe shoqërisë civile për të krijuar një hapësirë shoqërore dhe të ekonomisë të bazuar në njohuri dhe të dhëna.

*Në përgatitjen e analizës për këtë komponent kanë dhanë kontribut:*

#### **Ekspertë të Nivelit të Lartë**

*Dr. Ilda Muçmataj – Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës*

*Dr. Soffjana Veliu – Universiteti European i Tiranës*

*Ardita Seknaj – Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë në Shqipëri (ICC Albania)*

#### **Sekretariati Teknik**

*Teisa Kurti – Qendra A.L.T.R.I*